



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.558/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Besiana Maliqit kandidate për kuvendin komunal në Kamenicë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Kamenicë, paraqitur për shkak të mungesës të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017 në seancën e panelit të mbajtur me 31.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e Besiana Maliqit kandidate për kuvendin komunal në Kamenicë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Kamenicë, paraqitur për shkak të mungesës të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 30.10.2014, të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 24.10.2017 nga Besiana Maliqit kandidate për kuvendin komunal në Kamenicë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Kamenicë, në të cilën pretendon se në vendvotimin 1023D në Busavatë ka dyshime se formulari i plotësimit të listës së asambleistëve nuk është plotësuar si duhet pasi që siç thekson ajo ka pasur më shumë se 4 vota. Parashtruesi i ankesës thekson se parregullsi të tilla ka pasur edhe në vendvotimin 1001/03R, dhe kërkon që të rinumërohen votat në këto vendvotime.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsit në vendvotimet 1023D dhe 1001/03R, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatit e votimit, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës. Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës së Besiana Maliqit, nuk e paragjykon çështjen dhe ankuesës nuk i mohohet

e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZLAnr.558/2017 më datën 31.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.